

Ne sjellim dritë në errësirë.

Shpjegimi i faturës dhe mundësi pagimi

Fatura – thjeshtë e qartë.

Fatura juaj përbëhet në njërën anë nga një fletë me të dhëna të përgjithshme me kostot e përgjithshme të konsumimit tuaj të energjisë elektrike dhe të ujit si dhe shërbimet dhe taksat. Në anën tjetër ajo përmban një fletëpagesë. Në anën e pasme të faturës së energjisë ju gjeni udhëzime për **kohët e tarifave, shërbimin e gatishmërisë dhe ndërrimin e banesës**. Në faqet vijuese ju gjeni hollësitat për faturën dhe për konsumin tuaj.

Ju lutemi, jepeni gjithmonë numrin tuaj personal të **klientit**, nëse ju merrni kontakt me ne për shkak të faturës suaj të energjisë (me anë të telefonit, përmes formularit online, e-mailit ose me shkrim).

STADTWERK WINTERTHUR					
1	Informationen zur Verbrauchsperiode 01.01.2016 bis 31.03.2016	2	Kunde Vertragskonto Rechnung Rechnungsdatum	1034567 2045678 8001234567 06.04.2016	
3	Verbrauchsstelle: 56789012, Musterstrasse 90, 8400 Winterthur, Einfamilienhaus				
Details zur Rechnung					
4	Strom	11	12	13	14
	Bezeichnung	Menge	Einheit	Preis CHF	Nettobetrag CHF
A	Energieverbrauch, Basic				
	<small>Basiselles Stromprodukt: 10% e-Strom-Gold, 90% e-Strom-Bronze</small>				
	e-Strom-Gold	152	kWh	0.2100	31.92
	e-Strom-Bronze Normaltarif	602	kWh	0.0860	51.77
	e-Strom-Bronze Niedertarif	769	kWh	0.0640	49.22
	MwSt. 8.0%	10.63	Brutto	143.54	152.3
B	Netznutzung, Basic (2)				
	Netznutzung Normaltarif	754	kWh	0.1145	86.33
	Netznutzung Niedertarif	769	kWh	0.0620	47.68
	Grundpreis	3	Mt	11.00	33.00
	MwSt. 8.0%	13.36	Brutto	180.37	167.01
5	Gas (5)				
	Gasverbrauch, Basic				
	<small>Basiselles Gasprodukt: 9% e-Gas-Gold/95% e-Strom-Bronze</small>				
	e-Gas-Gold	60	kWh	0.1540	9.24
	e-Gas-Bronze	1140	kWh	0.0970	110.58
	Grundpreis	3	Mt	9.00	27.00
	MwSt. 8.0%	11.75	Brutto	158.57	146.82
6	Wasser				
	Verbrauch Wasser	55	m3	0.8500	46.75
	Leistungsgebühr 63.00 l/min/a	15.750	l/min	3.60	56.70
	MwSt. 2.5%	2.59	Brutto	106.04	103.45
7	Abgaben (gesetzlich)				
C	Abgaben an das Gemeinwesen (1)				
	Förderprogramm Energie Winterthur	1523	kWh	0.0032	4.87
	MwSt. 8.0%	0.39	Brutto	5.26	4.87
D	Bundesabgaben (1)				
	KEV inkl. Gewässerschutz (3)	1523	kWh	0.0130	19.80
	MwSt. 8.0%	1.58	Brutto	21.38	19.80
8	Klimafonds Stadtwerk Winterthur (1)				
	freiwilliger Beitrag zum regionalen Klimaschutz	1523	kWh	0.020	30.46
	MwSt. 0.0%	0.00	Brutto	30.46	30.46
9	Weitere Leistungen				
E	Abwasser (Verrechnung für Dept. Bau)				
	Mengenpreis Abwasser	47	m3	1.9920	93.62
	MwSt. 8.0%	7.49	Brutto	101.11	93.62
F	Abfall (Verrechnung für Dept. Bau)				
	Abfallgrundgebühr Einfamilienhaus	3	Mt	10.8025	32.41
	MwSt. 8.0%	2.59	Brutto	35.00	32.41
10	Total ohne Mehrwertsteuer				
					741.71

(1) Berechnungsgrundlage: Stromverbrauch in kWh
 (2) inkl. Systemdienstleistungen von Swissair AG (0.45 Rp./kWh)
 (3) Kostendeckende Einspeisevergütung (KEV) inkl. Bundesabgabe zum Schutz der Gewässer und Fische
 (5) ab 1.1.2016 Erdgas inkl. CO₂-Abgabe: 84 CHF pro Tonne CO₂ (=1.517 Rp./kWh)

Modeli i faturës: Çmimet janë pa garanci.

1 Periudha e konsumit

2 Numri i klientit

3 Vendi i konsumit

Objekti (banesa ose dyqani) mund të ndryshojë nga adresa e faturës.

4 Energjia elektrike

A Konsumi i energjisë elektrike llogaritet për orë të marrë kilovati (kWh). «Basic» përcakton grupin e klientëve, i cili është baza e çmimit të energjisë elektrike. Nën «**Produkti i porositur i energjisë elektrike**» ju e gjeni produktin e energjisë elektrike që keni zgjedhur ju. Çmimi llogaritet nga çmimet e produkteve të veçanta dhe të pjesës së porositur eventualisht të e-strom.Gold. Produktin tuaj të energjisë elektrike ju mund të ndryshoni në çdo kohë me anë të telefonit ose online (e-mail, internet). Në varësi nga instalimi ju e merrni energjinë elektrike me tarifën e thjeshtë ose me tarifën e dyfishtë (sipas orës së ditës **tarifa normale ose tarifa e ulët**).

B Shfrytëzimi i rrjetit i shënon kostot për infrastrukturën e rrjetit dhe mirëmbajtjen për furnizimin me energji elektrike (mirëmbajtja dhe rregullimi, pajisjet e matjes, leximi dhe faturimi). Çmimi për shfrytëzimin e rrjetit përbëhet nga një **çmim bazë** që është fikso dhe një element të çmimit që varet nga konsumi. Elementi i çmimit që varet nga konsumi llogaritet për kWh.

5 Gaz

Konsumi i gazit llogaritet për kWh të marrë. «Basic» përcakton grupin e klientëve, i cili është baza e çmimit të gazit. Nën «**Produkti i porositur i gazit**» ju e gjeni produktin e gazit që keni zgjedhur ju. Çmimi llogaritet nga çmimet e produkteve të veçanta dhe të pjesës së porositur eventualisht të e-Gas.Gold. Produktin tuaj të gazit ju mund të ndryshoni në çdo kohë me anë të telefonit ose online (e-mail, internet).

6 Uji

Në rast të **taksës së konsumit** bëhet fjalë për çmimin për metër kubik (m³) të ujit të marrë. Llogaritja bëhet çdo tremujor. **Taksa e shërbimit** matet në bazë të numrit dhe llojit të pikave të lidhura të furnizimit (p.sh. lavaman, nevojtoje etj.) dhe llogaritet në tremujor në litra për minutë/vit. Taksa mbi ndërtesat kërkohet një herë në vit së bashku me taksën për ujërat e zeza dhe kalon në llogarinë e bashkësisë së pronarëve të tokave.

7 Taksat (ligjore)

C Taksa që i paguhet komunës për financimin e **programit të nxitjes „Energji Winterthur“** llogaritet për çdo vend të konsumit dhe në bazë të konsumit individual të energjisë elektrike:

Details zum Verbrauch

	Zähler	Ablesung	Zählerstand		Faktor	Einheit	Verbrauch
			Alt	Neu			
Strom Normaltarif	877851	19.10.2015	57277	58031	1	kWh	754
Strom Niedertarif	877851	19.10.2015	48745	49514	1	kWh	769
Erdgas	100033365	19.10.2015	3321	3437	1.000	m ³	116
Umrechnung in kWh					10.21	kWh	1200
Wasser	200522625	19.10.2015	1560	1607	1	m ³	47

Klimafonds Stadtwerk Winterthur

Vielen Dank für Ihren Beitrag zum Klimafonds Stadtwerk Winterthur. Damit unterstützen Sie Projekte zum Klimaschutz (CO₂-Reduktion), zur Steigerung der Energieeffizienz sowie zur Förderung erneuerbarer Energien in Winterthur und Region.

D Taksat federale llogariten veç në bazë të konsumit individual të energjisë elektrike. Bëhet fjalë për taksat për pagesën e ushqimit që i mbulon kostot (KEV) për **nxitjen e energjive të rigjenerueshme** si dhe **për mbrojtjen e ujërave dhe të peshqve**. Këto taksa inkasohen dhe kalohen më tej me porosi të federatës.

E Klimafonds Stadtwerk Winterthur Nëse ju e përkrahni Klimafonds Stadtwerk Winterthur, këtu paraqitet kontributi vullnetar prej 2 Rappen për çdo kWh që merrni.

9 Shërbime të tjera

E Taksat për ujërat e zeza përbëhen nga taksa bazë dhe çmimi i sasisë. Të dyja Stadtwerk Winterthur i llogarit me porosinë e departamentit të ndërtimit të ulët të qytetit Winterthur. Taksa bazë duhet të paguhet një herë në vit në vjeshtë. Për më shumë informacione: www.tiefbauamt.winterthur.ch.

F Taksa bazë për mbeturinat i përmban kostot për infrastrukturën, plehrat dhe „turin e gjelbër“, „turin e letrave“, „pikat e grumbullimit“ etj. Stadtwerk Winterthur e llogarit këtë taksë me porosi të departamentit të ndërtimit të ulët të qytetit Winterthur. Në rast të pyetjeve: Departament Bau, Abfalltelefon Tel. 052 267 68 68 ose abfall@win.ch.

10 Shuma e përgjithshme pa tatim mbi vlerën e shtuar

11 Sasia

12 Njësia

13 Çmimi CHF

14 Shuma neto CHF

15 Kontatori

Çdo kontator ka një numër të qartë, i cili gjendet në kontator dhe është i regjistruar tek Stadtwerk Winterthur.

16 Leximi

Data e leximit të kontatorit.

17 Gjendja e kontatorit

E vjetër: Gjendja e kontatorit në periudhën paraprake.

E re: Gjendja e kontatorit në leximin aktual.

18 Faktori

Në rast të energjisë elektrike faktori është zakonisht 1. Në rast të gazit faktori shërben për konvertimin e vëllimit të matur të gazit në kWh.

19 Konsumi

Diferenca ndër gjendjes së vjetër dhe asaj të re të kontatorit, e shumëfishuar me faktorin nën pikën 18, rezulton konsumin tuaj efektiv.

Mundësi pagimi

Stadtwerk Winterthur ju ofron tre mundësi për ta paguar faturën tuaj të energjisë:

- Pagesë me faturë
- Metoda e debitimit direkt (LSV)
- Fatura elektronike (E-Rechnung)

Pagesë me faturë

Ju e merrni faturën e printuar në letër me postë dhe e paguani këtë me fletëpagesën brenda afatit të shënuar të pagesës tek posta ose banka. Nëse ju nuk dëshironi shprehimisht një tjetër mënyrë të pagesës, ju e merrni faturën tuaj me postë.

Metoda e debitimit direkt (LSV)


Me Debit Direct të bankës Postfinance ose me metodën e debitimit direkt të bankave zvicerane faturat tuaja të energjisë paguhen automatikisht gjithmonë në kohë. Debitimi i llogarisë bëhet gjithmonë automatikisht në ditën e maturimit të faturës. Me këtë ju përfitoni në dy aspekte: Nuk ka shpenzime postare për urdhërpagesat dhe juve nuk ju nevojitet kohë për t' i mbushur urdhërpage-

sat tuaja. Plotësoni formularin e aplikimit LSV online. Ju e gjeni nën www.stadtwerk.winterthur.ch (rubrika: Kundendienst, Formulare). Pastaj ne e debitojmë direkt llogarinë tuaj tek posta ose banka me shumat e faturës suaj. Ju mund ta shfrytëzoni në çdo kohë të drejtën tuaj të revokimit dhe mund ta anuloni urdhrin për debitimin direkt [LSV].

Fatura elektronike (E-Rechnung)

Që të jeni në gjendje të paguani me e-faturën, ju duhet të regjistrohni një herë në shërbimin e-banking të bankës suaj ose të Postfinance. Kështu ju e merrni faturën tuaj në rrugën elektronike, pavarësisht nga ajo, nëse i bëni pagesat tuaja me Postfinance ose me një bankë. Në platformën tuaj elektronike (e-banking) ju e kontrolloni faturën elektronike dhe jepni lejmimin për pagesën e saj. Faturën tuaj të detajuar merrni në formatin PDF. Ju mund ta refuzoni pagesën, nëse keni një reklamim.

Regjistrimi e-banking:



Nën www.e-rechnung.ch gjeni informacione të tjera.

Këtë shpjegim të faturës e gjeni nën www.stadtwerk.winterthur.ch/rechnungserklaerung në këto gjuhë:

Gjermanisht
Italisht
Frëngjisht
Anglisht
Spanjisht
Portugalisht
Shqip
Turqisht
Serbisht

Pyetje? Ne jemi të pranishëm për ju:

«Stadtwerk Winterthur»
Shërbimi i klientëve
Untere Vogelsangstrasse 11
8400 Winterthur

Adresa postare
Stadtwerk Winterthur
8403 Winterthur

Telefon 052 267 22 22
stadtwerk.kundendienst@win.ch
www.stadtwerk.winterthur.ch